V E N D I M
Nr. 577, datë 22.10.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E VORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit që preket nga ndërtimi i varrezave publike, në Bashkinë e Vorës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Vorës.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashklidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 3 020 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 3 020 000 (tre milionë e njëzet mijë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Vorës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 96 000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Vorës.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Tiranës për zatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA VORË

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Hanke Mahmut Hasrama	3020	1000	3020000